



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.2022

VENDIM

Nr. 321, datë 21.07.2022

PËR

**KUALIFIKIMIN E KANDIDATIT Z. {...},
PËR NË FORMIMIN FILLESTAR NË SHKOLLËN E MAGJISTRATURËS,
PËR MAGJISTRAT, PROFILI GJYQATAR, PËR VITIN AKADEMIK 2021-2022**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 21.07.2022, pasi u njoh me materialet e çështjes dhe Relacionin “Për gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, të kandidatit z. {...}”, përgatitur nga relatori z. Dritan Hallunaj, si dhe pasi shqyrtoi propozimin për kualifikimin e kandidatit z. {...} për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për magistrat, profili gjyqtar, për vitin akademik 2021-2022,

VËREN

I. PROCEDURA E VERIFIKIMIT

1. Z. {...} është kandidat për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, profili gjyqtar, në kushtet kur:

- a) është vlerësuar nga Shkolla e Magjistraturës, në bazë të Raportit të Vlerësimit Përfundimtar të datës 15.04.2021, se plotëson kriteret e pranimit në formimin fillestar për magistrat sipas nenit 28 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar (më poshtë referuar si Ligji për Statusin);
- b) ka marrë pjesë në provimin e organizuar nga Shkolla e Magjistraturës sipas nenit 31 të Ligjit të Statusit dhe është përfshirë në listën e renditjes së kandidatëve fitues në formimin fillestar për magistrat, profili gjyqtar, të miratuar me Vendimin nr. 17, datë 14.05.2021, të Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës, përcjellë pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor me Shkresën nr. 365/1 prot., datë 14.05.2021 (protokolluar në Këshill me aktin nr. 2222 prot., datë 14.05.2021).

2. Me Vendimin nr. 218, datë 26.05.2021, mbështetur në nenin 32 të Ligjit për Statusin, si dhe në Vendimin e tij nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë” (më poshtë referuar si

Vendimi 75/2019), Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur *fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit për në formimin fillestar për magistratë, profili gjyqtar, në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2021-2022*, duke caktuar relatorin për çdo procedurë verifikimi për secilin kandidat, ku në bazë të shortit, për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit *për kandidatin z. {...} si relator u caktua z. Ilir Toska*.

3. Më datë 26.05.2021, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në Seksionin A, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, kandidati, z. {...}, në rrugë elektronike, u njoftua: - për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit; - për caktimin e relatorit të kësaj procedure verifikimi; - për të drejtën që kishte për të kërkuar përjashtimin e relatorit të caktuar dhe/ose të çdo anëtar tjetër të Këshillit, brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e këtij njoftimi. Po ashtu, kandidati u njoftua edhe për detyrimin për plotësimin e formularit deklarues për adresën postare, adresën elektronike dhe kontaktit telefonik, për qëllimet e procedurës së verifikimit ndaj tij, formular ky që i është bashkëngjitur njoftimit.

4. Brenda afatit treditör, kandidati, z. {...}, depozitoi rregullisht të plotësuar formularin deklarues për adresën postare, adresën elektronike dhe kontaktit telefonik, për qëllimet e procedurës së verifikimit ndaj tij. Nga ana tjetër, në këtë afat, kandidati nuk parashtroi ndonjë pretendim në lidhje me relatorin e caktuar për procedurën e verifikimit ndaj tij apo për ndonjë anëtar tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

5. Më datë 01.06.2021, bazuar në pikën 8, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, kandidatit, z. {...}, në rrugë elektronike, iu dërguan formularët dhe autorizimet përkatëse (të përcaktuara në pikën 6, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019) që duhet të plotësoheshin dhe dorëzoheshin prej tij në kuadër të procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit.

6. Brenda afatit pesëditor, kandidati, z. {...}, depozitoi formularët dhe autorizimet përkatëse, ndërsa brenda afatit 21 ditor (sipas pikës 4, Seksioni A, Kreu IX, të Vendimit 75/2019), ajo dorëzoi rregullisht edhe formularin “Deklaratë e pasurisë dhe interesave private e kandidatit për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë” pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (më poshtë referuar si ILDKPKI).

7. Në vijim të procedurës së verifikimit, në datën 07.06.2021, bazuar në pikën 10, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, përmes shkresave të veçanta, u kërkua informacion dhe raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës, përcaktuar në nenin 32 të Ligjit të Statusit, për kandidatët për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, ndër ta edhe për z. {...}.

8. Institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës, kanë përcjellë për Këshillin e Lartë Gjyqësor informacionet dhe raportimet e tyre në kohë të ndryshme (siç do të përshkruhet më poshtë).

9. Gjatë procedurës së verifikimit, mbështetur në të dhënat e deklaruara nga vetë kandidati në jetëshkrimin e depozituar në rastin e aplikimit pranë Shkollës së Magjistraturës, në lidhje me eksperiencën e tij në punë (punësimin), si dhe në ato të marra nga organet e sigurimeve

shoqërore (me Shkresën nr. 3692/1 prot., datë 14.06.2021, të Institutit të Sigurimeve Shoqërore), bazuar në pikën 10, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, përmes shkresave të veçanta, u kërkua informacion nga subjektet që kanë mbikëqyrur disiplinën në punë të kandidatit z. {...}, të cilët kanë përcjellë për Këshillin e Lartë Gjyqësor informacionet e tyre në kohë të ndryshme (siç do të përshkruhet më poshtë).

10. Në Mbledhjen Plenare të datës 13.12.2021, me vendimin nr. 582, datë 13.12.2021, Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 147/b dhe 149, pika 5 e Kushtetutës së Republikës, në nenin 276, pika 7 e Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.5, datë 20.12.2018, “Mbi caktimin me short të mandatit 3- vjeçar të anëtarëve gjyqtarë dhe anëtarëve jogjyqtarë”, si dhe në vendimin e Mbledhjes së Përgjithshme të gjyqtarëve më datë 08.10.2021, vendosi deklarimin e mbarimit të mandatit të anëtarit të tij, z. Ilir Toska. Vendimi i mësipërm hyri në fuqi menjëherë. Me anë të vendimit nr. 601, datë 23.12.2021 “Për një ndryshim në vendimin nr.13, datë 18.01.2019 të KLGJ-së “Mbi ngritjen dhe përbërjen e komisioneve të përhershme” Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbështetje të nenit 62 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” të ndryshuar, vendimin nr.13, datë 18.01.2019 të KLGJ “Mbi ngritjen dhe përbërjen e Komisioneve të Përhershme”; vendimin nr. 5, datë 20.12.2018 të KLGJ; vendimin nr. 582, datë 13.12.2021 të KLGJ, është vendosur që përbërja e Komisioneve të Përhershme të jetë si vijon: “... Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (KZHK) Anëtarë: Klodian Kurushi, Dritan Hallunaj, Alban Toro. Anëtarë Zëvendësues: Marçela Shehu dhe Maksim Qoku.”

11. Si pasojë e mbarimit të mandatit të z. Ilir Toska, Këshilli me vendimin nr. 23, datë 17.01.2022, vendosi “Ndryshimin pjesërisht të pikës 2 të vendimit nr. 218, datë 26.05.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kandidatëve për në formimin fillestar për magistrat, profili gjyqtar, në shkollën e magistraturës, për vitin akademik 2021-2022”, nënpika 32, si më poshtë: Caktimin e relatorit për secilin kandidat, si më poshtë: 1. Për kandidatin z. {...} - relator z. Dritan Hallunaj

12. Brenda afatit, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në Seksionin A, Kreu VI, të Vendimit 75/2019 (i azhurnuar), kandidati, z. {...}, në rrugë elektronike, u njoftua: - për caktimin e relatorit të ri të kësaj procedure verifikimi dhe për të drejtën që kishte për të kërkuar përjashtimin e relatorit të caktuar, brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e këtij njoftimi.

13. Pas administrimit të dokumentacionit të nevojshëm, në përputhje me kërkesat e Vendimit 75/2019 (i azhurnuar), më datë 07.04.2022, relatori e parashtrroi çështjen përpara Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

14. Komisioni i Zhvillimit të Karrierës e shqyrtoi çështjen më datë 07.04.2022, bazuar në pikën 3, Seksioni C, Kreu VI, të Vendimit 75/2019 (i azhurnuar), vendosi kalimin e saj për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor për të vlerësuar dhe vendosur ky i fundit për kualifikimin ose skualifikimin e kandidatit {...} për në formimin fillestar për magistrat (profili gjyqtar) në Shkollën e Magistraturës.

II. REZULTATET E VERIFIKIMIT PËR KRITERET E PRANIMIT NË FORMIMIN FILLESTAR TË SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS

A. Për kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për pranimin në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për magjistrat

15. Sa i përket kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta për pranimin në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për magjistrat, përfshirë edhe për kandidatin {...}, si dhe më lart u parashtrua, vlerësimi për plotësimin e tyre është bërë, në momentin e kandidimit, nga ana e Shkollës së Magjistraturës, bazuar kjo në nenin 30¹ (“Kandidimi dhe vlerësimi paraprak i kandidatëve”) të Ligjit të Statusit. Në përfundim të vlerësimit, Shkolla ka përgatitur dhe i ka paraqitur Këshillit të Lartë Gjyqësor raportin për rezultatet e vlerësimit paraprak së bashku me dosjet me dokumentet e kandidimit për secilin kandidat, ku pas komenteve të Këshillit, më datë 15.04.2021, Shkolla ka miratuar dhe publikuar në faqen e saj zyrtare Raportin e Vlerësimit Përfundimtar, përfshirë dhe listën e kandidatëve, të cilët plotësonin kriteret e parashikuara në nenin 28 të Ligjit të Statusit. Në këtë listë është përfshirë dhe kandidati {...}.

16. Gjithsesi, për kandidatin {...}, u konsiderua verifikimi sërish i disa prej kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta për pranimin në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për magjistrat, përcaktuar në nenin 28 të Ligjit të Statusit.

16.1 Për këtë u mbajt në konsideratë diferenca kohore mes momentit të aplikimit të kandidatëve (Shkurt 2021), momentit të vlerësimit përfundimtar nga Shkolla e Magjistraturës për plotësimin e kriterëve nga ana e tyre (Prill 2021), si dhe momentit aktual, kur Këshilli duhet të shprehet për kualifikimin ose jo të kandidatëve për në formimin fillestar të Shkollës së Magjistraturës, të cilët kanë rezultuar fitues në provimin e pranimit (Shtator 2021). Dhe po ashtu, nga ana tjetër, u mbajt në konsideratë dhe fakti se shumica e kriterëve të pranimit në formimin fillestar janë potencialisht të ndryshueshëm në kohë (me përjashtim të kriterit arsimor, kriterit të përvojës profesionale, kriterit të anëtarësisë në parti politike, në kohën e kandidimit dhe kriterit të anëtarësisë, bashkëpunëtorit ose të favorizuarit nga Sigurimi i Shtetit përpara vitit 1990).

16.2 Gjithashtu, për këtë u mbajt në konsideratë se një verifikim i tillë është detyrim ligjor për Këshillin e Lartë Gjyqësor që buron nga neni 32 (“Verifikimi i pasurisë dhe figurës”),

¹ “1. Shkolla e Magjistraturës pranon aplikimet për pranimin në formimin fillestar, deri në fund të muajit shkurt të çdo viti. 2. Kandidatët paraqesin dokumentacionin e nevojshëm që vërteton përbushjen e kriterëve të parashikuara në nenin 28 të këtij ligji. Nëse dokumentacioni i paraqitur nuk vërteton plotësisht përbushjen e kriterëve, nuk është i plotë, i saktë, ose ka dyshime të arsyeshme për vërtetësinë e tij, Shkolla e Magjistraturës mund të kërkojë informacion ose dokumentacion shtesë nga organet publike ose punëdhënësit e kandidatit. 3. Deri në datën 15 mars të çdo viti, Shkolla e Magjistraturës kryen një vlerësim paraprak, nëse kandidati përbush kriteret e kandidimit, të parashikuara në nenin 28 të këtij ligji. 4. Shkolla e Magjistraturës i paraqet Këshillave raportin për rezultatet e vlerësimit paraprak së bashku me dosjet me dokumentet e kandidimit për secilin kandidat. Këshillat mund të japin komente ose kundërshtime jo më vonë se në fund të muajit mars të çdo viti. Shkolla e Magjistraturës miraton raportin e vlerësimit përfundimtar, duke marrë në konsideratë komentet dhe kundërshtimet e bëra, dhe publikon raportin e vlerësimit përfundimtar në faqen e saj zyrtare, duke përfshirë listën e kandidatëve, të cilët plotësojnë kriteret e parashikuara në nenin 28 të këtij. 5. Çdo kandidat, i cili nuk është përfshirë në listën e kandidatëve, të cilët plotësojnë kriteret, ka të drejtë të ushtrojë mjetet ligjore të ankimit, të parashikuara në ligjin “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” dhe aktet nënligjore përkatëse”.

pika 4/1², shkronja “ç”, të Ligjit të Statusit, sipas të cilit Këshilli ka detyrimin të verifikojë ekzistencën e çdo shkaku përjashtues (të parashikuar nga ligji) nga kandidimi për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës. Përveç kësaj, u mbajt në konsideratë detyrimi i Këshillit për verifikimin e kriterëve të zgjedhshmërisë, të cilat janë njëherazi edhe kriteret e pranimit në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, pra ato sipas nenit 28 të Ligjit të Statusit, është një detyrim konstant i Këshillit qoftë në momentin e emërimit të diplomuarve për magjistrat (profili gjyqtar) në Shkollën e Magjistraturës, ashtu edhe gjatë karrierës së tyre si magjistrat (gjyqtar), referuar për këtë në nenet 35, 64 dhe 66 të Ligjit të Statusit.

17. Konkretisht, për kandidatin u verifikua:

a) zotësia e plotë për të vepruar. Për kandidatin nuk u gjet ndonjë e dhënë për heqjen apo kufizimin e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë;

b) shtetësisë shqiptare. Në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës, kandidati ka depozituar dokumentin “Kartë Identiteti”, lëshuar nga Ministria e Brendshme më datë 15.10.2020, në të cilin përbërësi i gjendjes civile “shtetësia”, pasqyrohet “shqiptare”, ndërkohë që gjatë verifikimit për kandidatin nuk u gjet ndonjë e dhënë për heqjen e shtetësisë shqiptare. Gjithashtu, nga verifikimi i bërë, më datë 23.06.2021, në regjistrin kombëtar elektronik të gjendjes civile të administruar nga Ministria e Brendshme (Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile), sipas certifikatës personale elektronike të printuar në letër nga nëpunësi i ngarkuar i Këshillit, konstatohet se kandidati vijon të ketë shtetësinë shqiptare;

c) gjendja gjyqësore. Në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës, kjo e fundit ka kryer verifikim në regjistrin elektronik gjyqësor të administruar nga Ministria e Drejtësisë (Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve) duke printuar në letër Certifikatë Elektronike datë 11.02.2021, ndërkohë që gjatë verifikimit, në kuadër të verifikimit të figurës së kandidatit, u administruan Shkresa nr. 6269/1 prot., datë 17.06.2021, e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve (Sektori i Gjendjes Gjyqësore). Sipas këtyre dokumenteve, kandidati nuk ka shënime në sistem;

ç) disiplina në punë. Në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës kandidati ka depozituar dokumentin “Kthim përgjigje” nga Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, lëshuar me datë 24.02.2021, sipas të cilës “nuk rezulton asnjë masë disiplinore e administruar në dosje”, ndërkohë që gjatë verifikimit u administruan Shkresa me nr. 177/2 prot., datë 15.06.2021, e Dhomës Kombëtare të Avokatisë, Tiranë. Sipas dokumentit kandidati nuk ka patur dhe nuk ka masë disiplinore në fuqi; Gjithashtu, nga Avokatura e Shtetit, me shkresën nr. 2515/1 prot., datë 14.06.2021 përcillet informacioni: “Për periudhën duke fillur nga data 03.02.2015 dhe deri në datën e kësaj shkrese, për z. {...} nuk është marrë asnjë masë disiplinore dhe as nuk ka procedurë disiplinore të filluar ndaj tij.”

² “4/1. Këshillat vendosin që kandidati nuk kalon procesin e verifikimit të pasurisë dhe figurës kur: ...; ç) ka ndonjë shkak tjetër përjashtues të njohur, të parashikuar sipas ligjit”.

d) mosqenia bashkëpunëto, informatore, ose agjente e shërbimeve sekrete. Në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës, kandidati ka depozituar një deklaratë, të dorëzuar në momentin e bërjes së kërkesës, që nuk përmban datë, në të cilën deklarohet se nuk ka qenë bashkëpunëtor, informator, ose agjent i shërbimeve sekrete, ndërkohë që gjatë verifikimit nuk u gjet ndonjë e dhënë për qenien e kandidatit bashkëpunëtor, informator, ose agjent i shërbimeve sekrete.

18. Për kriteret e tjera të pranimit në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës u konsiderua vlerësimi i bërë nga kjo e fundit dhe konkretisht për:

a) pasjen e kriterit arsimor. Në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës, kandidati ka depozituar dokumentet: “Diplomë –në Drejtësi”, sipas sistemit të vjetër 4 vjeçar, me nr.45, datë 12.07.2007, lëshuar nga Fakulteti i Drejtësisë Universiteti Luarasi si dhe Vërtetim Notash datë 22.02.2017 lëshuar nga po ky Universitet; ‘Vërtetim njohje dhe njësimi’ lëshuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, Komisioni i Njohjes së Diplomave, nr. 1063 regj., datë 04.06.2015, për njohjen e diplomave të z. {...} lidhur me studimet e përfunduara në Francë.

b) pasjen e përvojës profesionale. Në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës kandidati ka depozituar dokumentin “Vërtetim nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë” nr. 938 prot., datë 07.02.2020, sipas të cilit rezulton pagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për kandidatin, personi fizik/juridik {...} “Avokat”, regjistruar me NIPT L32110005T, për periudhën Prill 2014 - Dhjetor 2017 (me shkeputje vetëm për periudhën Shkurt 2015 – Maj 2015). Si e tillë, kandidati ka përvojë profesionale aktive në sektorin privat me kohë të plotë, në profesionin “Avokat”, person fizik, për periudhën si më sipër. Ndërkohë, me shkresën nr. 2515/1 prot., datë 14.06.2021, të Avokaturës së Shtetit, Zyra e Avokatit të Përgjithshëm, jemi vënë në dijeni se z. {...}, “ka qenë i punësuar pranë Avokaturës së Shtetit, në pozicionin e Avokatit të Shtetit, nga data 03.02.2015 deri më datë 05.06.2015, kur është larguar me dorëheqje.” Me vërtetimin nr. 720/16 prot., datë 25.02.2021, lëshuar nga Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, jemi vënë në dijeni se: “...z. {...} ka qenë punonjës i Institucionit tonë, dhe ka punuar si më poshtë: 09.02.2021 – 27.02.2018 specialist, pranë Sektorit të Marrëdhënieve Ligjore, 27.02.2018 – 14.09.2020 përgjegjës sektori, pranë Sektorit të Marrëdhënieve Ligjore të Drejtorisë Juridike, në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë”.

c) mos anëtarësinë në parti politike në kohën e kandidimit. Në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës, kandidati ka depozituar një deklaratë në të cilën deklarohet se nuk është anëtar i ndonjë partie politike;

ç) mosqenien anëtare, bashkëpunëto ose e favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara vitit 1990. Në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës, kandidati ka depozituar një deklaratë në të cilën deklarohet se nuk ka qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara vitit 1990, përveç se referuar moshës së tij (e datëlindjes 17.05.1984), ai nuk mund të ketë qenë i tillë.

B. Për kriterin e pasurisë

19. Për kandidatin {...} u verifikua kriteri i pasurisë, përcaktuar në pikën 1, të nenit 32, të Ligjit të Statusit, sipas të cilës: *“1. Kandidatët me rezultatet më të larta në listën e publikuar, sipas përcaktimeve të nenit 31, të këtij ligji, të cilët mund të pranohen në formimin fillestar të Shkollës së Magjistraturës, i nënshtrohen verifikimit të plotë të pasurisë ...”*.

20. Për verifikimin e kriterit të pasurisë për kandidatin {...}, u kërkua raportim nga institucionet publike kompetente të përcaktuara në pikën 2, të nenit 32, të Ligjit të Statusit. Ky raportim u kërkua për kandidatin si dhe për bashkëshorten e tij, znj. Flavia {...}, në kushtet kur ajo konsiderohet “person i lidhur” në kuptim të Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar (nenet 3 dhe 5), si dhe Ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar (neni 2).

21. Konkretisht, për verifikimin e kriterit të pasurisë për kandidatin {...}, u kërkua raportim nga ILDKPKI-ja, e cila ka dërguar në Këshillin e Lartë Gjyqësor Raportin nr. 511/23 prot., datë 16.09.2021.

21.1 Sipas këtij Raporti të ILDKPKI-së, kandidati {...} dhe personi i lidhur me të ka plotësuar dhe depozituar në afatin e caktuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor formularin e deklaratës së pasurisë dhe interesave privatë, si dhe autorizimet e kërkuara për verifikimin e pasurisë.

21.2 Po ashtu, sipas këtij Raporti të ILDKPKI-së, nga kjo e fundit është kryer kontrolli i plotë për pasuritë, asetet dhe interesat privatë të deklaruara nga kandidati {...} dhe personi i lidhur me të, duke konkluduar se për kandidatin:

- a) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
- b) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë;
- c) nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- d) nuk ka kryer deklarim të rremë;
- e) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

21.3 Referuar rezultateve të kontrollit të plotë për pasuritë, asetet dhe interesat privatë dërguar nga ILDKPKI për kandidatin z. {...}, Relatori, më datë 10.12.2021 me anë të komunikimit elektronik ka parashtruar disa pyetje si vijon, ...omissis.. *“1. Në deklaratën e pasurisë dhe interesave privatë, sikundër edhe në sqarimet tuaja përpara ILDKPKI-së, si burim të krijimit të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme keni deklaruar dhurime nga Shoqëria “A.K” shpk, me ortak të vetëm dhe administrator z. Astrit Kuqi, babai i bashkëshortes tuaj. Është e nevojshme të sqaroni nëse subjekti tregtar në fjalë ka deklaruar në organet tatimore pakësimin e pasurisë së tij, qoftë në lidhje me pasuritë e paluajtshme, ashtu dhe sa i përket mjeteve monetare, duke saktësuar vlerën e tyre të dhuruara ndër vite sipas deklarimeve tuaja. Po ashtu, është e nevojshme të sqaroni nëse për shkak të transaksioneve në favorin tuaj apo të bashkëshortes, subjektit tregtar në fjalë i kanë lindur detyrime tatimore dhe, nëse po, a janë paguar ato, duke paraqitur dokumentacion përkatës (bilancet vjetore dhe pasqyrat financiare) të konfirmuar nga organi tatimor. 2. A keni patur ju dhe bashkëshortja juaj të ardhura të tjera, përveç atyre nga puna dhe të dhuruara nga Shoqëria “A.K” shpk? Nëse po, evidentoni këto të ardhura dhe ligjshmërinë e përfitimit të*

tyre, shoqëruar me dokumentacionin përkatës provues. 3. Evidentoni udhëtimet tuaja, bashkëshortes dhe fëmijëve, jashtë vendit, për periudhën nga viti 2011 dhe deri në momentin e deklarimit, duke sqaruar shpenzimet e bëra për secilin udhëtim, si dhe burimin e të ardhurave për përballimin e tyre. 4. Evidentoni shpenzimet e bëra për arredimin e banesës ku jetoni, si dhe burimin e të ardhurave për përballimin e tyre. 5. Evidentoni shpenzimet e bëra për edukimin dhe arsimimin e fëmijëve, si dhe burimin e të ardhurave për përballimin e tyre. 6. Sipas Kontratës së Dhurimit nr. 982 rep., dhe nr. 375 kol., datë 08.05.2020, Notere XH. O, Shoqëria "A.K" shpk ka dhuruar në favorin tuaj dhe të bashkëshortes një apartament, që është deklaruar nga ana juaj si në pronësinë tuaj në deklaratën e pasurisë dhe interesave privatë. Në këtë kontratë, si përfaqësuese e palës dhuruese ka vepruar bashkëshortja juaj, sipas Prokurës së Përgjithshme nr. 962 rep., dhe nr. 361 kol., datë 07.05.2020, notere XH.O. Pra, sipas kontratës, bashkëshortja juaj ka vepruar si përfaqësuese e dhuruesit, por edhe si përfituese nga dhurimi. Referuar përmbajtjes së prokurës së përgjithshme, si dhe përmbajtjes së nenit 67 të Kodit Civil, kërkohen sqarime nëse kontrata e dhurimit ka qenë e aftë për kalimin e të drejtës së pronësisë mbi apartamentin. 7. Në deklaratën e pasurisë dhe interesave privatë keni deklaruar si pasuri tuajën dhe bashkëshortes një automjet, të markës "Volkswagen", model "Tiguan", blerë me leasing. Është e nevojshme dhënia e sqarimeve nëse ju dhe bashkëshortja juaj jeni bërë pronarë të këtij automjeti, referuar kushteve të kontratës së paraqitur nga ana juaj dhe detyrimeve që ju mbartni sipas saj..."

21.3.1 Në përgjigje të emailit të datës së mësipërme, z. {...}, përmes komunikimit elektronik të datës 14.12.2021, parashtron: "Une {...}, kandidat për profilin gjyqtar, me date 10.12.2021, jam vene ne dijeni te kerkeses per sqarime, lidhur me proceduren e verifikimit qe po zhvillohet ndaj meje. I vene ne dijeni te faktit se relatori i ceshitjes time z. Ilir Toska me date 13.12.2021 ka dorezuar mandatin e tij si anetar i KLGJ, po ju drejtohem me kerkese per shtyrjen e afatit te lene per dhenien e sqarimeve te kerkuara. Ne pamundesi per te siguruar dokumentacionin perkates, pasi kerkesa per sqarime me ka ardhur ditën e premtë pasdite ne email me date 10 dhe afati i lene ne dispozicion eshte 5 dite, si dhe duke patur ditet e fundjaves pushim ne mes, gjendem ne pamundesi objektive per te permbushur keto kerkesa ne vetem 2 dite. Ne keto kushte kerkoj te me jepet nje afat tjeter kohor."

21.3.2 Në përgjigje të kësaj kërkesë të z. {...}, si pasojë e faktit se relatorit, z. Ilir Toska i kishte mbaruar mandati i anëtarit, deklaruar kjo me vendimin nr. 582, datë 13.12.2021 të Këshillit, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, duke u bazuar në vendimin nr. 13, datë 18.01.2019 "Mbi ngritjen dhe përbërjen e Komisioneve të Përhershme të Këshillit të Lartë Gjyqësor", përbërë nga znj. Marçela Shehu, z. Alban Toro dhe z. Dritan Hallunaj (anëtar zëvendësues) me vendimin nr. 2675/81 prot., datë 17.12.2021, vendosi të pranojë kërkesën dhe të zgjasë afatin për paraqitjen e sqarimeve deri më datë 17.01.2022.

21.3.3 Në përgjigje të pyetjeve, z. {...}, më datë 16.01.2022 me anë të komunikimit elektronik ka parashtruar sqarime si vijon: "Për pyetjen e 1, për përfitimin e pasurive të paluajtshme, behët fjalë për një apartament me siperfaqe 140.2 m2 dhuruar nga shoqeria "A.K" sh.p.k. Në lidhje me këtë apartament janë paguar të gjitha detyrimet që kanë lindur për vlerën e deklaruar prej 18.506.400 leke. Këto deklarime janë bërë në bilancin e vitit 2020, vit në të cilin është bërë kontrata e dhurimit. Kjo gjë konfirmohet me anë të shkresës me nr.1107 Prot datë 17.12.2021 "Konfirmim Bilanci", të Drejtorisë së Shërbimit të Tatimpaguesve të Mëdhenj, me anë të të cilës bëhet konfirmimi I pasqyrave financiare të shoqërisë "A.K" sh.p.k për vitin 2020 (Shih bilancin dhe pasqyrat financiarete vitit 2020

pasqyra e performancës, të ardhura, po ashtu dhe bilanci pakësimi i aktivëve). Për sa i përket dhurimeve të mjeteve monetare nga ana e babit të bashkëshortes për bashkëshorten time, e bija e tij, e kam objektivisht të pamundur të jap një shifër të saktë të dhurimeve, pasi bëhet fjalë për marrëdhënie të posacme prind-fëmijë, dhe në keto marrëdhënie nuk mbahen evidenca apo shënime për shumat e dhëna mes palëve. Në cdo rast, kur dhurimi është bere nga shoqëria janë bërë dhe deklarimet përkatëse në administratën tatimore, sic është rasti për pagesat për makinën ëolsvagen që ne disponojmë, deklarim I cili figuron në shkresën e sipërcituar nga Drejtoria e Shërbimit të Tatimpaguesve të Mëdhenj. Për pyetjen e 2, në lidhje me këtë pyetje sqaroj se përvec atyre që kam deklaruar në ILDKPI, unë dhe bashkeshortja ime nuk disponojmë pasuri të tjera. Për pyetjen e 3, në lidhje me këtë pyetje sqaroj se në bazë të informacionit të marrë nga sistemi TIMS, rezulton se: Për vitin 2011 kam dalë 4 herë jashtë shtetit, përkatësisht: Paris, Itali, Mal te Zi, Austri, Slloveni. Për vitin 2012 kam dalë 2 herë jashtë shtetit, përkatësisht: Itali, Gjermani.

Për vitin 2013 kam dalë 3 herë jashtë shtetit, përkatësisht: Itali.

Për vitin 2014 kam dalë jashtë shtetit 4 herë, përkatësisht: Itali, Maqedoni, Mal i Zi.

Për vitin 2015 kam dalë jashtë shtetit 8 herë, përkatësisht: Mal i Zi, Itali, Slloveni.

Për vitin 2016 kam dalë jashtë shtetit 7 herë, përkatësisht: Itali, Kosovë, Mal i Zi, Turqi, Greqi.

Për vitin 2017 kam dalë jashtë shtetit 6 herë, përkatësisht: Francë, Itali, Mal i Zi.

Për vitin 2018 kam dalë jashtë shtetit 6 herë, përkatësisht: Itali, Turqi, Greqi, Mal i Zi.

Për vitin 2019 kam dalë jashtë shtetit 10 herë, përkatësisht: Itali, Greqi, Maqedoni, Turqi, Francë.

Për vitin 2020 kam dalë jashtë shtetit 1 herë, përkatësisht: Itali.

Për vitin 2021 kam dalë jashtë shtetit 6 herë, përkatësisht: Francë, Turqi, Greqi, Emirate të Bashkuara Arabe (Dubai), Mal i Zi.

Të gjitha udhëtimet që kam evidentuar me sipër janë kryer me shpenzimet e bëra nga ana e babait të bashkëshortes time. Sqaroj gjithashtu se në shume udhëtime që kemi kryer, sidomos Greqi dhe Itali, I kemi kryer pranë familjarëve tanë që jetojnë në këto vënde, që do të thotë se shpenzimet kanë qenë fare minimale. Shpenzimet e sakta që kemi kryer cdo udhëtim, duke vecuar ato pranë familjarëve tanë në Greqi dhe Itali, e kam objektivisht të pamundur të përcaktoj pasi kanë kaluar shumë vite dhe kane qenë shumë udhëtime, por nëse do më duhej të përcaktoja një mesatare shpenzimi për udhëtim do të thoja 500 – 1000 euro. Për sa i përket burimit të krijimit, sic thashë kanë qenë të financuara nga ana e babit te bashkëshortes dhe burimi I krijimit të tyre janë dy kontrata shitblerje pasurie e paluajtshme. Përkatësisht kontrata me nr.1338 Rep dhe nr.729 Kol date 02.04.2012 me vlerë 33,750,000 lekë, dhe kontrata me nr.1242 Rep dhe nr.354/3 Kol date 22.07.2011 me vlere 7,280,000 leke. Këto kontrata janë nënshkruar prej babit të bashkeshortes dhe nëna e saj, në cilësinë personale dhe jo në cilësinë e përfaqësuesve të shoqërisë “A.K” sh.p.k. Keto shuma kane sherbyer per te financuar keto udhëtime dhe mjaft gjera te tjera. **Për pyetjen e 4**, për sa i përket arredimit të banesës sqaroj se nuk është bërë i gjithi në një moment por në vazhdimësi. Për arredimin e tij janë përdorur të ardhura të siguruara nga puna ime, e bashkëshortes, dhurime monetare

nga ana e babit të bashkëshortes. Sqaroj se një pjesë e mobiljeve, kuzhina, krevate, dhomë gjumi janë bërë me porosi pranë punishteve të zdrukthtarëve lokalë. Vlera e tyre kane qenë relativisht të ulta, ku për kuzhinën kemi paguar 150.000 mije lekë, dhomë gjumi 140.000 mije leke, dhe dy dhoma fëmijësh nga 70.000 mijë lekë secila. Për sa I përket elektroshtëpiakeve, frigorifer, lavatrice sqaroj se janë blerë me nje vlerë të përafërt për frigoriferin prej 70.000 mije lekësh, për lavatricen për një vlerë të përafërt prej 30.000 mije lekësh, Televizori 80.000 mije lekë, hidrosanitaret dhuratë nga ana e babit të bashkëshortes. Kur referoj vlerat të përafërta dhe jo me saktësi, e bëj për shkak se faturat për blerjet e bëra nuk I kam ruajtur, dhe vlerat me saktësi nuk I kujtoj. Për cdo shpenzim për pajisjet e sipërpërmendura ka qenë babi I bashkëshortes që I ka kryer. Ndërkohe unë me bashkëshorten kemi berë shpenzime për pjesën tjetër të arredimit të shtëpisë, duke blerë kryesisht në tregjet e lira të kryeqytetit si psh: tek Tregu Cam, Tregu Elektrik etj. Shpenzimet e kryera nga ana e babit të bashkëshortes për blerjet e mësipërme kanë burimin tek dy kontratat e shitblerjes së pasurive të paluajtshme të përmendura më lart. Për pyetjen e 5, shpenzimet për edukimin e fëmijëve janë suportuar nga ana e e shoqërisë “A.K” sh.p.k, shoqëria e babit të bashkëshortes, I cili ka paguar të gjitha detyrimet tatimore që rezultojnë nga shpërndarja e dividendit për këtë qëllim kjo gjë konfirmohet prej shkresës me nr.1107 Prot datë 17.12.2021 “Konfirmim Bilanci” të DSHTM (Drejtoria e Shërbimit të Tatimpaguesve të Mëdhenj). Pagesa për edukimin e të dy fëmijeve për vitet 2018-2020 janë:

- 2018 – 6.885 euro
 - 2019 – 12.940 euro
 - 2020 – 9.480 euro
- Gjithsej 29.305 euro.

Për sa më sipër shoqëria “A.K” sh.p.k ka shpërndarë dividend në fund të vitit 2020 duke deklaruar të gjitha detyrimet tatimore që lindin nga ky veprim (shih bilancin dhe pasqyrat financiare të vitit 2020, pasqyra e fluksit të mjeteve monetare në zërin dividend të paguar pronarëve dhe bilanci tek pasivi I fitimit të mbartur). Gjithashtu, po ju vendos në dispozicion edhe faturat bankare për keto pagesa të kryera nga ana e bashkeshortes time për këtë qëllim. Për pyetjen e 6, në përgjigje të kësaj pyetje sqaroj se në bazë të nenit 67 te Kodit Civil: Përfaqësuesi nuk mund të kryejë veprime juridike në emër të të përfaqësuarit as me veten e tij dhe as me persona të tjerë të përfaqësuar prej tij, përveç kur i përfaqësuarit e ka lejuar këtë shprehimisht, ose kur përmbajtja e veprimit juridik nuk cenon interesat e tij.

Babi i bashkëshortes time, Astrit Kuqi, në cilësinë e administratorit dhe ortakut të vetëm të shoqërisë “A.K” sh.p.k, I ka dhënë një prokurë të përgjithshme vajzës së tij, bashkëshortes time, për të kryer veprime të ndryshme në interes të shoqërisë. Në kuadër të kësaj prokure, bashkëshortja ime ka firmosur edhe kontratën e dhurimit me nr. 982 Rep dhe nr.375 Kol datë 08.06.2020, ku si palë përfituese e kësaj kontrate është ajo dhe unë. Kjo kontratë në vlerësimin tim ligjor është plotësisht e aftë për kalimin e pronësisë nga shoqëria tek ne si çift bashkëshortësh, pasi vet neni 67 e lejon një veprim të tillë kur nuk dëmtohen interesat e të përfaqësuarit, pra shoqërisë. Në rastin konkret personi që vlerëson nëse veprimi I kryer nga ana e bashkëshortes time dëmton interesat e shoqërisë “A.K” sh.p.k, është administratori dhe ortaku I vetëm I saj, babi I bashkëshortes time. Thënë kjo, në vlerësimin tim nuk mund të dëmtohen interesat e një prindi kur bën dhuratë për fëmijën e tij. Jo vetem kaq, por shoqëria e ka paguar edhe dividend për ketë dhurim të kryer. Nëse nuk do të ishte dakort me kontratën e dhurimit nuk do te kishte proceduar me pagesën e detyrimit tatimor që lind prej shpërndarjes së dividendit, por do kishte kundërshtuar kontratën e dhurimit në gjykatë, gjë të cilën nuk e ka bërë. Në këtë kuadër në vlerësimin tim, kontrata e dhurimit e firmosur prej

bashkëshortes time si përfaqësuese e shoqërisë “A.K” sh.p.k, ku përfituese e asaj kontrate jam unë dhe bashkëshortja ime, është plotësisht e vlefshme për transferimin e pronësisë. Për pyetjen e 7, në përgjigje të kësaj pyetje sqaroj se makina vazhdon të jetë në pronësi të bankës deri në pagesën e plotë të shumës së përcaktuar në kontratën e leasing. Vetëm pasi të kemi paguar të gjithë shumën në fjalë atëherë në mund të bëhemi pronarë. Për momentin jemi vetëm përdorues të saj. Kontrata e leasing mbyllet në 01.07.2023.

Në përfundim, me lejon t’ju them se jam në dispozicionin tuaj për çdo sqarim të mëtejshëm që mund të nevojitet...”

21.4 Pas administrimit të dokumentacionit të paraqitur si më sipër nga z. {...}, relatori, në vijim të procedurës së verifikimit dhe shpjegimeve të mëparshme të dhëna, më datë 11.03.2022, përmes komunikimit elektronik, ka kërkuar sqarimin e disa çështjeve dhe paraqitjen e dokumenteve provuese, si vijon: *“Sipas deklarimeve dhe akteve që ju keni paraqitur, ka rezultuar që pjesa më e madhe e burimit të gjitha pasurive tuaja, dhe bashkëshortes tuaj, Flavia {...}, janë likuiditete të z. Astrit Kuqi (vjehtëri juaj). Rezulton sipas DRT Tiranë se, z. Astrit Kuqi, si ortak i vetëm i Shoqërisë “A.K” shpk, ka tërhequr dividend, vetëm në vitin 2019, ndërsa në vitet e tjera fitimi ka kaluar kryesisht për investime. Sa më sipër, kërkohet nga ana juaj të dokumentoni marrëdhënien e z. Astrit Kuqi dhe/ose familjarët e tij, nëse janë hua, dhuratë etj, nga Shoqëria “A.K” shpk? Nëse shoqëria disponon ndonjë akt apo vendim në lidhje me transferimin e këtyre fondeve?”*

21.4.1 Përmes komunikimit elektronik të datës 16.03.2022, z. {...} ka kërkuar shtyrje të afatit, si vijon: *“... Ne përgjigje të "Kërkeses tuaj për sqarime" të datës 11.03.2022, brenda mundësive tuaja, do t'ju kerkoja shtyrje të afatit të dorëzimit të materialit sqarues, pasi një pjesë e materialit me duhet ta kerkoj pranë ASHK, gje e cila kerkon kohe për t'u siguruar. Në këto kushte, brenda mundësive, do t'ju kerkoja shtyrje të afatit për plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm...”*

21.4.2 Më datë 17.03.2022, relatori i ka komunikuar z. {...}, vendimin nr. 1662 prot., datë 17.03.2022, me anë të cilit ka vendosur pranimin e kërkesës së tij dhe zgjatjen e afatit për paraqitjen e sqarimeve deri më datë 25.03.2022.

21.5 Brenda afatit të përcaktuar në vendimin e mësipërm, konkretisht më datë 25.03.2022, z. {...} ka parashtruar sqarimet si vijon: *“Në lidhje me konstatimin tuaj se z. Astrit Kuqi, vjehtëri im, ka tërhequr dividend vetëm në vitin 2019. Në lidhje me këtë përfundim, dua t’ju rikujtoj se me anë të dokumentacionit sqarues të dorëzuar prej meje më datë 17.01.2022, dokumentacion të cilin jua kam nisur edhe të skanuar më datë 16.01.2022, ju kam paraqitur edhe shkresën me nr.1107 Prot datë 17.12.2021 “Konfirmim Bilanci” të DRT. Me anë të këtij dokumentacioni vërtetohet që shoqëria “A.K” sh.p.k ka shpërndarë dividend edhe për vitin 2020, jo vetëm për 2019. Duke qene se dhurimet që shoqëria më ka bërë mua dhe bashkëshortes time konsiderohen si shpërndarje dividendi në bazë të ligjit, atëherë nga ana e shoqërisë “A.K” sh.p.k është bërë pagesa e detyrimit mbi dividendin e shpërndarë në këtë vit. Detyrimet mbi këtë dividend të shpërndarë rezultojnë të paguara me anë të mandat pagesës (faturës bankare) bashkangjitur këtij emaili, mandat i dorëzuar prej meje gjithashtu edhe pranë KLGJ më datë 24.03.2022. Në shkresën me nr. 1107 Prot datë 17.12.2021 “Konfirmim Bilanci” janë pasqyruar edhe dhurimi i apartamentit tim të banimit, pagesat për makinën të marr me leasing, si dhe pagesat për shkollimin e fëmijëve të mi. Kërkesë nga*

ana juaj për të dokumentuar marrëdhënien e z. Astrit Kuqi me shoqërinë "A.K" sh.p.k, në lidhje me fondet e tërhequra nga kjo shoqëri dhe kalimin e tyre në llogarinë time dhe të bashkeshortes time znj. Flavia Kuqi.

Në lidhje me këtë kërkesë sqaroj se nuk ka patur asnjëherë terheqje nga llogaritë e shoqërisë "A.K" sh.p.k dhe kalimin në llogaritë e mija apo të bashkeshortes time. Une nuk disponoj, as nuk kam disponuar ndonjëherë një llogari timen, e cila kreditohet me fonde të marra nga shoqëria në fjalë. Të vetmet sende të përfituara nga ana ime prej shoqërisë janë apartamenti i dhuruar, pagesa e kësteve mujore të makinës së marr me leasing dhe shpenzimet për shkollimin e fëmijëve. Shpenzimet e sipërpermendura janë të gjitha të pasqyruara në bilancin e vitit 2020, të konfirmuar me anë të shkresës me nr.1107 Prot datë 17.12.2021 të DRT Tiranë, të cilat janë në formë dhurimi nga ana e shoqërisë "A.K" sh.p.k. Për këto shpenzime shoqëria në fjalë ka paguar të gjitha detyrimet që rrjedhin sipas ligjit tatimor në fuqi, e vërtetuar kjo gjë nga "mandat pagesa" bankare që vërteton pagimin e dividendit për shpenzimet në fjalë.

Pra, të gjitha shpenzimet e mësipërme të kryera nga ana e shoqërisë konsiderohen si dhurime nga ana e ligjit tatimor, gjë e cila krijon detyrime për shoqërinë nëse ajo të ketë shpërndarë dividend për ortakun e vetëm të saj. Për këtë shkak, shoqëria ka paguar detyrimet mbi dividendin, që vërtetohet me anë të mandat pagesës të cilin po ja bashkangjisim këtij emaili.

Në lidhje me shpenzimet e tjera, që z.Astrit Kuqi, në cilësinë e tij personale tashmë dhe jo si ortak i shoqërisë "A.K" sh.p.k, ka bërë për vajzen e tij, bashkeshorten time Flavia {...} (Kuqi), nuk ka patur kontrata formale huaje ndërmjet saj dhe babait të saj, pasi për shkak të marrëdhënieve të posaçme që kanë me njëri tjetrin nuk mundet të mbanin kontrata për shuma të caktuara të hollash, që bashkeshortja ime ka marrë prej tij kur e ka çmuar të arsyeshme. Kërkohet informacion në lidhje me fondet e përdorura nga ana e z. Astrit Kuqi dhe/ose familjaret e tij, nëse janë dhuratë apo hua nga ana e shoqërisë "A.K" sh.p.k, dhe nëse po a ka ndonjë akt në lidhje me transferimin e këtyre fondeve. Në lidhje me këtë kërkesë, më duhet ta sqaroj në dy momente: a) Nëse kërkesa juaj për sqarime ka të bëjë me fondet që z. Astrit Kuqi dhe bashkeshortja e tij znj. Lirie Kuqi kanë përdorur për mua dhe bashkeshorten time ndër vite, duke filluar nga 2011.

Me anë të përgjigjes së kthyer nga ana ime me datë 16.01.2022, ju kam vendosur në dispozicion dy kontrata shitblerje të pasurive të paluajtshme që z. Kuqi dhe znj. Kuqi kanë shitur në 2011, dhe fondet e siguruar nga këto shitje i kanë përdorur, herë pas here, për të mbuluar shpenzimet që unë dhe bashkeshortja ime kemi patur ndër vite, duke filluar nga 2011. Këto kontrata kanë përkatësisht numrat: nr. Rep 1242 dhe Kol 354/3 datë 22.07.2011, dhe kontrata me nr.1338 Rep dhe Kol 729 date 02.04.2012, me një vlerë të përbashkët prej rreth 40.000.000 lekësh të reja. Për origjinen e këtyre dy pronave ju kam vendosur në dispozicion edhe mënyrën sesi ato janë përfutur prej z. Kuqi dhe znj.Kuqi. Ju bëj me dije se, prona e shitur prej znj. Kuqi është blerë prej saj shoqërisë "A.K" sh.p.k që në vitin 2001, me fonde që, sipas deklarimeve të znj. Kuqi, kanë qenë kursime të babait të saj të ndjerë që ja kishte lënë vjerres time, znj. Kuqi. Ju bëj me dije se në këtë kohë unë as që nuk njihesha me bashkeshorten time të ardhshme, dhe kam qënë minorene, rreth 15 vjeç.

Ju rikujtoj gjithashtu që z. Kuqi dhe znj. Kuqi nuk kanë financuar gjithmonë shpenzimet tona. Unë kam punuar edhe avokat privat, me shkeputje, në vitet 2013, 2014 etj, Avokat Shteti Për Arbitrazhin 6 muaj në 2015, me një pagë rreth 100 mijë lekë, dhe së fundmi për 3 vjet

Përgjegjës i Sektorit Ligjor në QSUT, me një pagë rreth 60.000 mije lekë. Pra edhe une kam siguruar të ardhurat e mia nga puna ime. Bashkeshortja ime gjithashtu ka punuar si arkitekte prane kompanisë së babait të saj. Pra edhe ne kemi arritur të siguronim të ardhura për jetesën tonë dhe jo çdo gjë e kemi të ardhur prej z. Kuqi dhe znj. Kuqi, megjithëse e ndihmonin herë pas here vajzën e tyre me shuma të vogla të hollash. b) Nëse kërkesa juaj për sqarime ka të bëjë me fondet e perdoruara nga z. Kuqi dhe/ose familjarët e tij, për jetesën e tyre të përditëshme, dhe nëse këto janë hua nga shoqëria “A.K” sh.p.k, dhe nëse po a ka ndonjë akt për këto fonde.

Në përgjigje dua të sqaroj se: une në asnjë moment nuk kam jetuar në një shtëpi apo familje me familjarët e bashkeshortes time. Nuk kam qenë asnjëherë në certifikatë familjare me ata, dhe nuk kam djeni se ku i kane gjetur fondet z. Kuqi dhe familjarët e tij për të jetuar apo për të përmbushur nevojat e jetës së përditëshme. Por nga diskutimet që kam patur me ta, për të cilët në bazë të ligjit nuk kam asnjë përgjegjësi, i kam kërkuar shpjegime në funksion të pyetjeve që më janë shtruar në kuadër të procesit tim të rivlersimit si gjyqtarë. Nga përgjigjet që kam marrë prej tyre më është thënë se fondet janë siguruar nga shitja e objektit të ndertimit të blerë nga ana e vjerrës time në 2001 shoqërisë “A.K” sh.p.k, objekt i ndërtuar nga shoqëria në 2001 dhe i blerë nga ana e vjerrës ne 2001, në fazën e karabinasë. Me përfundimin e ndërtimit të tij dhe me shitjen e apartamenteve më pas, janë siguruar mjaft fonde – ndër të cilat figuron dhe apartamenti i shitur në 2011, me anë të të cilit janë mbuluar një pjesë e shpenzimeve të miat dhe bashkeshortes time nga viti 2011 e në vazhdim – që kanë bërë të mundur jetesën e familjes së z. Kuqi dhe familjarëve të tij. Kontrata e shitblerjes së vitit 2001 ndërmjet shoqërisë “A.K” sh.p.k dhe vjerrës time, znj. Lirie Kuqi, po jua vendos në dispozicion të skanuar dhe dorëzuar pranë KLGJ. Duke qenë në gadishmëri për sqarime të mëtejshme, ju uroj gjithë të mirat!...”

18. Për verifikimin e kriterit të pasurisë për kandidatin {...} u kërkuar informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

18.1 Nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve informacioni u dërgua me Shkresën nr. 10493/1 prot., datë 25.06.2021, me shkresën nr. 12252/1 prot., datë 12.07.2021 dhe me shkresën nr. 19100/3 prot., datë 27.09.2021, (Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë) ku për kandidatin {...}, subjekt tatim pagues me status person fizik (Avokat) pranë Drejtorisë Rajonale Tiranë që prej periudhës shtator 2013 (me status “Pasiv” më datë 26.01.2019) e në vijim. Sipas informacionet të përcjell nga Drejtorisë Rajonale Tiranë subjekti z. {...}, më datë 21.09.2021 ka Gjyba të Regjistruara në vlerën 5000 Lek (si pasojë e mosdeklarimit të TVSH-së në afat).

18.2 Nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave informacioni u dërgua me Shkresën nr. 10356/1 prot., datë 30.06.2021, ku për kandidatin {...} konstatohet se ka kryer një procedurë doganore import më datë 19.07.2013 në D.D. Tiranë (si dhe është dërguar Deklarata Doganore datë 19.07.2013, lidhur me zhdoganimin e mjetit tip Autoveturë Volksëagen, blerë në Francë).

19. Në mbledhjen e datës 07.07.2022, Këshilli i Lartë Gjyqësor, vlerësoi të kërkojë informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, lidhur me shpërndarjen apo jo të dividendit nga ana e subjektit “AK” shpk, me administrator dhe aksioner z. Astrit Kuqi. Si e tillë, me shkresën nr. 3943 prot., datë 08.07.2022 u kërkuar informacion nëse subjekti në fjalë

ka shpërndarë dividend për vitet 2019, 2020 dhe 2021, shoqëruar me dokumentet përkatëse provuese, si vendimet e asamblesë, apo çdo dokument tjetër që disponohet nga ata.

20. Me anë të shkresës protokolluar pranë KLGJ-së nr. 3943/2 prot., datë 19.07.2022, Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, sqaron si vijon: “...lidhur me shpërndarjen e dividendit për vitet 2019, 2022 dhe 2021, ju bëjme me dije se nga verifikimi në sistemin tatimor C@ts, rezulton si më poshtë: 1. Për vitin 2019 shoqëria rezulton me fitim sipas sipas deklaratës vjetore të tatim fitimit në shumën 44.031.247 lekë. Kjo shoqëria nuk ka ngarkuar në sistemin tatimor C@ts vendimin e asamblesë së ortakut. 2. Për vitin 2020 shoqëria rezulton me fitim sipas deklaratës vjetore të tatim fitimit në shumën 19.512.477 lek. Shoqëria ka dorëzuar vendimin e asamblesë së ortakut nr. 2, datë 30.06.2021 për destinimin e fitimit sipas pasqyrave financiare për vitin 2020. 3. Për vitin 2021 shoqëria rezulton me fitim sipas deklaratës vjetore të tatim fitimit në shumën 16.687.562 lekë. Për destinimin e fitimit të vitit 2021 shoqëria është në afat për dorëzimin e vendimit të Asamblesë së Ortakëve. Gjithashtu ju bëjme me dije se nga verifikimi i sistemit C@ts rezulton se shoqëria AK, me Nipt J82226002M, ka shpërndarë 10.000.000 lekë dividend dhe ka paguar tatim mbi dividendin në vlerën 800.000 lekë në muajin mars 2021.”

21. Lidhur me sa më sipër, për faktin se vjehri i kandidatit z. {...}, nuk ka shpërndarë dividend për një periudhë të caktuar, Këshilli çmon të mbahet në konsideratë jurisprudenca e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në vendimin nr. 14 (JR), datë 16.05.2022³, (rast i ngjashëm me situatën e kandidatit). Konkretisht në këtë vendim, Kolegji ka arsyetuar: “...17.8 në përmbledhje, trupi gjykues vëren që kjo shkelje administrative, ... e kryer nga personi i lidhur, në kushtet dhe rrethanat konkrete, nuk mund të argumentohet se përlligj zbatimin e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit e do të ishte disproporcionale në raport me qëllimin për të cilin është ndërtuar procesi i rivlerësimit. Ky konkluzion, përpos faktit që shkelja nuk përbën veprime të kryera nga vetë subjekti dhe është kundravajtje administrative që i drejtohet vetë personit përgjegjës ... dhe që veprimi rezulton të jetë pasqyruar në regjistrat kontabël të shoqërisë, që teorikisht lejon kontrollimin e administratës tatimore ... merr në konsideratë dhe faktin se veprimet kanë ndodhur para emërimit të subjektit në detyrë...”. Në konsideratë të sa më sipër, në kushtet kur edhe në rast të një shkelje administrative, ajo nuk është kryer personalisht nga kandidati, por nga vjehri i tij, kjo situatë nuk mund të jetë e tillë që të penalizojë atë me moskualifikimin e tij për të filluar programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës.

22. Gjithashtu, ashtu si rezulton nga shkresa e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, sipas paragrafit më sipër, shoqëria AK, me Nipt J82226002M, ka shpërndarë 10.000.000 lekë dividend dhe ka paguar tatim mbi dividendin në vlerën 800.000 lekë në muajin mars 2021. Sa u shtjellua më sipër, lidhur me vlerësimin e kriterit pasuror të kandidatit, Këshilli vlerëson se veprimet e vjehrit të tij, lidhur me të gjitha arsyet e mësipërme, nuk mund të passjellin skualifikimin e kandidatit dhe të bëjë të papranueshme ndjekjen nga ai të programit të formimit fillestar për magjistrat në Shkollën e Magjistraturës. Një masë e tillë, do të ishte joproportionale dhe do tejkalonte qëllimin e verifikimit.

³ Vendimi Komisioneri Publik vs Atalanta Zeqiraj

23. Në vijim, nga verifikimi i kriterit të pasurisë për kandidatin {...} janë grumbulluar të dhëna të mjaftueshme mbi të cilat mund të konkludohet se për të nuk ekziston asnjë prej shkaqeve të skualifikimit nga formimi fillestar për në Shkollën e Magjistraturës sa i përket kriterit të pasurisë, patur parasysh për këtë përcaktimin e shkronjës “a”, pika 4/1, të nenit 32, të Ligjit për Statusin, sipas të cilit: “4/1. Këshillat vendosin që kandidati nuk kalon procesin e verifikimit të pasurisë ... kur: a) burimet financiare të kandidatit nuk justifikojnë pasuritë e tij dhe nuk ka deklaruar pasuri ose asetë duke i fshehur ato, ose në mënyrë të qëllimshme ka dhënë një deklaratë të rreme ose jo të saktë të asetëve, ose kandidati gjendet në situatën e konfliktit të interesit; ...”. Konkretisht, për kandidatin verifikohet që:

- a) kandidati ka plotësuar dhe depozituar rregullisht formularin e deklaratës së pasurisë;
- b) kandidati ka plotësuar dhe depozituar rregullisht, të nënshkruara, autorizimet e kërkuara për verifikimin e pasurisë;
- c) kandidati ka burime financiare për të justifikuar pasuritë e tij;
- ç) deklarimi nga kandidati i pasurisë, asetëve ose të interesave private, të detyrueshme për t’u deklaruar, është i plotë, i vërtetë dhe i saktë.

C. Për kriterin e figurës

24. Për kandidatin {...} u verifikua kriteri i figurës, përcaktuar në pikën 1, të nenit 32, të Ligjit të Statusit, sipas të cilës: “1. Kandidatët me rezultatet më të larta në listën e publikuar, sipas përcaktimeve të nenit 31, të këtij ligji, të cilët mund të pranohen në formimin fillestar të Shkollës së Magjistraturës, i nënshtrohen verifikimit të plotë të ... figurës”.

25. Konkretisht, për verifikimin e kriterit të figurës për kandidatin {...}, u kërkuar raportim nga institucionet ligjzbatuese të përcaktuara në pikën 2, të nenit 32, të Ligjit të Statusit.

26. Nga raportimet e Institucionit ligj zbatues dhe verifikues nuk kanë rezultuar të dhëna papërshtatshme me funksionin e gjyqtarit.

27. Po ashtu, për verifikimin e kriterit të figurës për kandidatin {...}, atij iu kërkuar dhe plotësoi e depozitoi rregullisht pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, më datë 07.06.2021, formularin e vetëdeklarimit sipas kërkesave të Ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, si dhe autorizimin për Këshillin që, në zbatim të pikës 2 të nenit 32 të Ligjit për Statusin, të kryejë verifikimin në organet kompetente sipas ligjit, të dhënave të tij në lidhje me figurën dhe integritetin.

28. Po në kuadër të zbatimit të Ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, mbi kërkesë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Gjendjes Civile, me Shkresën nr. 2287/1 prot., datë 09.07.2021, protokolluar në Këshill me aktin nr. 2619/1 datë 12.07.2021, ka dërguar të dhënat për përbërësit e gjendjes civile edhe për kandidatin {...} pas verifikimeve

të bëra në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile të vitit 2010 dhe në zyrat përkatëse të gjendjes civile.

29. Bazuar në informacionin e dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve (Sektori i Gjendjes Gjqësore) sipas shkronjës “c”, pika 12, e këtij relacioni, si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Gjendjes Civile, nëpunësi përgjegjës i strukturës së posaçme pranë Këshillit të Lartë Gjqësor, pasi kreu verifikimet e rastit, nuk konstatoi mangësi në të dhënat e deklaruara nga kandidati {...} në formularin e vetëdeklarimit sipas kërkesave të Ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, duke konkluduar se kandidati: - *ka dorëzuar formularin e vetëdeklarimit më datë 07.06.2021; - formulari është regjistruar me numrin unik 000596; - vetëdeklarimi është bërë publik, në faqen zyrtare ëeb të KLGJ-së; - në formular, nuk ka të deklaruar të dhëna që përfshihen brenda sferës së ndalimeve të parashikuara me ligj; - nuk ka deklaruar gjeneralitete të mëparshëm; - Sektori i Gjendjes Civile, ka raportuar se ka kryer për këtë shtetas procedurën e shkëmbimit të numrit personal nga I40517070A në I40517071A, siç e ka deklaruar dhe se nuk ka ndryshime të tjera në përbërësit e gjendjes civile, Sektori i Gjendjes Gjqësore, personi rezultoi “i padënuar”-nga gjykatat penale shqiptare; - deri më sot nuk kemi pasur indicie apo të dhëna kryesisht, për të kërkuar verifikim të thelluar nga Prokuroria e Përgjithshme”. Për pasojë, u vlerësua që nuk kishte vend për verifikim shtesë nga Prokuroria e Përgjithshme.*

30. Po ashtu, për verifikimin e kriterit të figurës për kandidatin {...}, mbi kërkesën e Këshillit të Lartë Gjqësor, Prokuroria e Përgjithshme ka kryer verifikimin përkatës në të gjitha prokuroritë që ushtrojnë veprimtari në Republikën e Shqipërisë, duke përcjellë në Këshill, me Shkresën nr. 924/25 prot., datë 08.09.2021, protokolluar me aktin nr. 2674/1, datë 08.09.2021, përgjigjet zyrtare të 22 (njëzet e dy) prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë. Gjithashtu, u administrua dhe përgjigja e Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, përcjellë në Këshill, me Shkresën nr. 6161/1 prot., datë 03.09.2021, protokolluar me aktin nr. 3785/1, datë 07.09.2021. Referuar përmbajtjes së këtyre përgjigjeve rezultoi se për kandidatin {...}, nuk është regjistruar kallzim/referim/procedim penal, nuk ka qenë ose është në hetim, nuk është caktuar ndonjë masë sigurimi, nuk është dënuar me vendim jopërfundimtar apo të formës së prerë për kryerjen e ndonjë veprë penale.

31. Nga verifikimi i kriterit të figurës për kandidatin {...} janë grumbulluar të dhëna të mjaftueshme mbi të cilat mund të konkludohet për të nuk ekziston asnjë prej shkaqeve të skualifikimit nga formimi fillestar për në Shkollën e Magjistraturës sa i përket kriterit të figurës, patur parasysh përcaktimet e shkronjave “b” dhe “c”, pika 4/1, të nenit 32, të Ligjit për Statusin, sipas të cilave: “4/1. Këshillat vendosin që kandidati nuk kalon procesin e verifikimit të .. figurës kur: ...; b) kandidati ka lidhje ose kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar; c) ka shfaqur sjellje të rënda të papërshtatshme etike dhe morale që cenojnë besimin e publikut në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë; ...”. Konkretisht, për kandidatin verifikohet që:

- a) kandidati ka plotësuar dhe depozituar rregullisht formularin e vetëdeklarimit sipas kërkesave të Ligjit nr.138/2015;

- b) kandidati ka plotësuar dhe depozituar rregullisht, të nënshkruara, autorizimin për Këshillin e Lartë Gjyqësor që, në zbatim të pikës 2 të nenit 32 të Ligjit për Statusin, të kryejë verifikimin në organet kompetente sipas ligjit, për të dhënat që lidhen me figurën dhe integritetin e tij;
- c) për kandidatin nuk ka të dhëna për lidhje ose kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar;
- ç) për kandidatin nuk ka të dhëna që të ketë qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara datës 2 korrik 1991, në kuptimin e Ligjit nr.45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”;
- d) për kandidatin nuk ka të dhëna që të ketë qenë ose të jetë bashkëpunëtor, informator ose agjent i shërbimeve të inteligjencës;
- dh) për kandidatin nuk ka të dhëna të tjera të atilla në lidhje me figurën dhe integritetin e tij mbi të cilat të mund të konkludohet për papranueshmërinë e ndjekjes nga ai të programit të formimit fillestar për magjistrat në Shkollën e Magjistraturës, sikurse më sipër u arsyetua.

III. KONKLUZIONE

32. Referuar përcaktimeve të Vendimit 75/2019, nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar gjatë procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për kandidatin z. {...}, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se procedura e verifikimit e ndjekur në këtë rast është e plotë dhe në përputhje me ligjin.

33. Bazuar në sa më lart është parashtruar mbi rezultatet e verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për kandidatin z. {...}, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se kandidati përmbush këto kriterë, ndërsa nuk ekziston ndonjë shkak për skualifikimin e tij. Nisur nga kjo, Këshilli çmon se është vendi për kualifikimin e kandidatit për në formimin fillestar për magjistrat, profili gjyqtar, në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2021-2022.

PËR KËTO ARSYE

Mbështetur në nenin 32, pika 5, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 61, pika 1, në nenin 86, shkronja “ë” dhe në nenin 97, pika 1, shkronja “a”, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe në Kreun VI, Seksioni Ç, pika 12, shkronja “a”, të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, i azhurnuar, Këshilli i Lartë Gjyqësor,

1. Kualifikimin e kandidatit z. {...}, për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për magjistrat, profili gjyqtar, në vitin akademik 2021-2022.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR